



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*



## P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më **29.04.2021** me fillim në ora **15.30**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

**Kryetari**- Më lejoni t'i përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSB, Nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, Drejtorët e Drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec z. Fazli Morina, Përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezent këtu që përfaqësojnë nga pikëpamja e sigurisë që kontribuojnë në komunën e Rahovecit, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e tret e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përpara e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2021 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës.. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

### Rend Dite

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19;**
3. **Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,**
  - Shqyrtimi i dukurive negative, me theks të veçantë trajtimi i objekteve jo të sigurta në Komunën e Rahovecit;
  - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla;
  - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit;
  - Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror;
4. **Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike;**
5. **Të Ndryshme.**

**Kryetari** - A ka dikush të shtojë diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

#### **1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim: Konstatoj s enë mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalomë në pikën e dytë të rendit të ditës:

#### **2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19.**

**Kryetari** – Të nderuar për këtë pikë të rendit të ditës fjalën ja japë drejtorit të shëndetësisë z. Samir Mustafa, që të na informoj sa i përket situatës së krijuar me pandeminë Covid – 19.

**Samir Mustafa** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, gjendja momentale në komunën e Rahovecit me Covid – 19 është stabile dhe e menagjueshme. Aktualisht nga paraqitja e Covid – 19 deri më tani kemi 1154 raste, deri më tani rastet të shëruara janë 824 raste, aktive 260 raste, kurse me fatalitet ose me vdekje janë fatkeqësisht 70 raste. Ne jemi duke vazhduar dezinfektimin e objekteve shëndetësore dhe objektet e tjera institucionale.

**Kryetari** – Të nderuar fjala është e juaja nëse keni diçka të shtoni sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës. Nëse jo do i them unë disa fjalë, ne së bashku me disa drejtor dhe komandantin e policës dhe

disa tjerë jemi pjesë e shtabit emergjent komunal dhe nëse ju keni pyetje ne jemi të gatshëm të ju përgjigjemi.

**Sabahudin Durguti** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha ta di se sa vaksina për Covid - 19, janë kryer në komunën e Rahovecit.

**Samir Mustafa** – Ne si komunë deri më tani kemi pranuar 610 doza të vaksinës Astra – Zeneca nga Ministria e Shëndetësisë, fillimisht është vaksinuar stafi shëndetësorë, tani jemi duke zbatuar rekomandimet e Ministrisë së shëndetësisë për vaksinimin e popullatës sipas planeve të MSH. Poashtu jemi duke vazhduar me testimin e popullatës me teste rapid, ku kryesisht janë duke u bërë deri në 35 teste në ditë. Aktualisht nuk kemi vaksina rezervë në QKMF, presim që të vinë dozat tjera dhe gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit do të njoftohen pastaj me rrjedhën e vaksinimit.

**Kryetrari** – Ne duhet që të respektojmë masat dhe rekomandimet e dala nga MSH, poashtu duhet të ndikojmë në format e ndryshme tek qytetarët tanë që ti respektojnë masat që janë në fuqi. Ju e dini se kemi pasur një sfidë me masat e dhënë nga MSH, ku për 12 ditë i kemi pasur disa masa më të rënda, por unë në emër të qytetarëve të komunës së Rahovecit kam bërë presion dhe kam kërkuar që masat që i kishim dikur të jenë në fuqi dhe të bëhet më shumë presion që ato masa të respektohen, e jo të kemi kufizime të reja. sepse të gjithë e dimë që tani është një sezon e punës dhe ne si vend bujqësor tani e kemi kohën e punës, besoj se qeveria qendrore nga ky presion i komunave e ka rikthyer gjendjen e masave të mëhershme, përveç që ka mbetur ora policore.

**Konkluzion** - Gjendja me Covid – 19 në Komunën Rahovecit është e menaxhueshme dhe stabile, gjithashtu i bëjë thirrje qytetarëve të komunës së Rahovecit që ti respektojnë rekomandimet e dala nga MSH. Furnizimi me barna esenciale ka filluar edhe pse kemi pasur sfida të mëdha si për barna esenciale poashtu edhe me materiale anti Covid – 19, por ky problem është zgjidhur.

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

### **3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit.**

Unë si kryetar disponoj raporte ditore nga stacioni policor në Rahovec, me të gjitha statistikën, gjendja në komunën tonë vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, nuk ka akcese të cilat duhet të brengosen qytetarët e komunës sonë, janë disa akcese të vogla por që gjendja në komunën tonë në përgjithësi është stabile. Për këtë pikë është praktik që të raportoj komandanti i stacionit policor z. Fazli Morina.

**Fazli Morina** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket situatës së krijuar me pandeminë Covid – 19, do ju japë disa informata: , ne zonën tone te përgjegjesisë, gjate periudhës raportuese, të gjitha njësitet e S.P. Rahovec, të asistuar sipas nevojës edhe nga patrullat policore te NJSO-se dhe NJRKRR-se, kane qene të angazhuara në implementimin e Planit Operativ të DRP-se Gjakove „Për Gatishtëmëri dhe Reagim për Corona Virus COVID-19”. Po ashtu patrullat tona kane bere asistimin e Inspektoreve komunal duke bashkëvepruar sipas kërkesave dhe nevojave ne teren, për menaxhimin e situatës se pandemisë Covid-19. Në kuadër të këtij plani, gjatë periudhës raportuese, ne S.P Rahovec janë regjistruar statistikën e aktiviteteve policore si ne vijim; Janë shënuar 727 gjoba bazuar në Ligjin NR 07/L-006, për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, prej tyre 613 gjoba për mos vendosjen e maskës mbrojtëse, 93 gjoba për mos respektim te orarit te lëvizjes, dhe 21 gjobe për organizime ta ndaluara. Kaq kisha sa i përket Covid – 19, në komunën e Rahovecit.

**Situata e Siguresë së Përgjithshme** - Në territorin e Komunës së Rahovecit, gjatë kësaj periudhe, ka qene e qetë dhe stabile. Gjatë kësaj periudhe, ne S.P. Rahovec janë regjistruar gjithsejtë: 45 Raste, prej tyre 42 vepra penale dhe 3 incidente të ndryshme. Nga këto raste mund të veçojmë disa vepra më të rënda: Vjedhje, 6 raste, vjedhje të rënda, 8 raste, për fate të keqe kemi pasur ritje të rasteve dhunë në familje, 5 raste. Lidhur me rastet e cekura, nga njësitet kompetente në kuadër të stacionit policor në Rahovec dhe Hetimeve Rajonale ne Gjakove, janë ndërmarr të gjitha veprime e nevojshme.

**Siguria në komunikacionin rrugor** - Policia e Kosovës në vazhdimësi ndërmerr masat e nevojshme për ngritjen e sigurisë në komunikacion, për të mundësuar dhe përmirësuar lëvizjen e lirë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion. Por ajo që është shqetësuese është se edhe këtu kemi rritje 100% të aksidenteve në trafik, por për fat të mirë pa viktima vetëm me dëme materiale, aksidentet kryesisht janë bërë brenda në qytat dhe nëpër parkingjet e marketave. Gjate periudhës raportuese, nga policia e

S.P. Rahovec, janë shënuar 553 gjoba për kundërvajtje ne komunikacionin rrugor, 2 prej tyre për prishje të rendit dhe qetësisë publike.

**Siguria në shkolla** - Policia e Kosovës në vazhdimësi është e përkushtuar lidhur me sigurinë në objektet shkollore, ku gjate periudhës raportuese, janë bërë vizitat ne shkolla dhe kontaktet me kuadrin arsimor, njëkohësisht edhe pika te kontrollit afër shkollave te zonës tone te përgjegjësise.

Vazhdon implementimi i Planit Operativ “Siguria në Shkolla” 2020/2021,

me aktivitete policore ne drejtim te shtimit te masave te sigurisë për nxënës dhe kuadrin arsimor.

Sa i përket rasteve ne shkolla, gjate përudhesh raportuese, ne shkollat e zonës tone te përgjegjësise, është raportuar vetëm një rast “Lëndim i lehte trupor” dhe “Kanosje”, i cili ka ndodhur ne shkollën fillore “Isa Boletin” ne Rahovec me datën 27.04.2021. Rasti ne konsultim me Prokurorin e Shtetit, ka shkuar ne procedure te rregullt.

Desha të shtoj edhe diçka, neve si polici e Kosovës na kanë angazhuar edhe me një projekt i cili nuk ka të bëjë fare me ne, bëhet fjalë për projektin “Bombolat e Gazit Vrasin “ , por me angazhimin tonë dhe stafit komunal, së bashku me inspektorët komunal janë vizituar dhe inspektuar te gjitha pompat e derivateve qe merren me shitjen e gazit ne zonën tone te përgjegjësise, aktivitete te cilat janë evidentuar ne raport te veçantë. Sipas inspektimit tonë dhe inspektoratit gjendja nuk qëndron aspak mirë kudo qoftë ku ka shitje dhe përdorim të gazit, nuk kanë licencë, stafi nuk është i trajnuar. Kmei edhe një projekt i cili është shumë i mirëseardhur për komunën tonë, ai është projekti: Kamerat e Sigurisë, me datën 27.04.2021, nga ora 09:30, kompania “Tetroniks”, nen-kontraktuese për vendosjen e kamerave të sigurisë në qytetin e Rahovecit, ka filluar punimet për vendosjen dhe instalimin e rrjetit të kamerave, në shtylla elektrike dhe lokacione të caktuara në qytet. Po ashtu në hapësirën e dhomës te radio komunikuesi në S.P. Rahovec, janë vendosur dhe montuar gjashtë (6) monitor, të dedikuar për ndërlidhje me kamerat e sigurisë, të cilët do të shërbejnë për monitorimin e situatës se sigurisë. Dje gjatë punimeve te tyre, kane hasur ne pengese nga inspektorët e komunës se Rahovecit, qe sipas tyre ju kane shkruar një procesverbal. Punimet do të vazhdojnë edhe ditëve në vijim, deri në përfundimin e instalimit të kamerave të sigurisë në qytetin e Rahovecit dhe në udhëkryqin e fshatit Xërxë. Gjatë këtij muaji e kemi pasur edhe një takim me banorët e fshatit Hoç e Madhe, lidhur me qarkullimin e bagëtive nëpër fshat dhe në kullosa në periferi të fshatit, mbajtur nga zyrtarët policor dhe disa qytetarë të fshatit Hoç e Madhe me datë 06.04.21, në ambient të hapur ku kanë marrë pjesë rreth 25 banor të këtij fshati, kryetari i fshatit, zyrtare nga OSBE dhe KFOR- LMT. Tema e diskutimeve ka qenë "Kullosat e bagëtive në fushat e fshatit Hoç e Madhe. Ndërsa takimi i radhës është mbajtur në sallën e S.P Rahovec me datën 08.04.2021 në ora 11:00, në të cilin kanë marrë pjesë Unë, Z.P në Komunitet, Z.P në sektorë, dy përfaqësues nga OSBE, disa blegtorë nga Rahoveci dhe kryetari i fsh. Hoç e Madhe Miroslav Lukiç. Në takim janë diskutuar shqetësimet lidhur me demet e shkaktuara nga bagëtitë e disa pronareve nga Rahoveci, për të cilat blegtorët shprehen keqardhje për pamundësinë e evitimit të frekuentimit të bagëtive në ato anë për shumë arsye si: mungesa e kushteve elementare për kafshë, mungesa e ujit, e kullosave etj, si pasojë e shitjeve të maleve e fushave që janë bërë nga shteti, që me çast blegtorëve ju kanë kufizuar shumë terrene. Kryetari i fsh. Hoç e Madhe, ka kërkuar që kjo dukuri të evitohet nga pronarët e kafshëve dhe të parandalohet dëmtimi i kullosave dhe arave të mbjella. Nga ana jone është diskutuar lidhur me pasojat ligjore në rast të raportimit të ndonjë rasti të dëmeve eventuale. Të gjithë pronarët e bagëtive që ishin prezentë, janë pajtuar me kërkesën e diskutuar në takim dhe kanë premtuar se kjo dukuri nuk do të përsëritet më. Kaq ishte nga ana ime nëse ka dikush të shtoj diçka, këtu jam për t’ju përgjigjur.

**Fadil Sylka** – Përshëndetje për të gjithë, pyetje ime ka të bëjë rreth semaforëve në qytet, mendoj se rregullimi i semaforëve nuk është në rregull, sepse të njëjtën kohë ndezët e gjelbërta për makinat që qarkullojnë majtas ose djathtas, poashtu u jepet edhe këmbësorëve të drejtë kalimi. Mendoj se kjo kishte me qenë mirë të rregullohet që kur të kenë të drejtë kalimi këmbësorët, makinat të kenë dritën e kuqe ne semafor. Poashtu edhe tek semaforët tek ambulanca, një rrugë nuk ka fare qasje në semafor, pse nuk është gjetur ndonjë zgjidhje që të vendoset edhe në këtë rrugë semafori.

**Fazli Morina** – Mbi të gjitha është bërë një punë e mirë vendosja e semaforëve të ri, kurse sa i përket qasjes edhe te makinave edhe të këmbësorëve në të njëjtën kohë, nuk janë semaforët e vetëm këto, ke

në Prizren dhe në shumë vende tjera. Kurse sa i përket semaforëve tek ambulanca, si duket fjalën e ke tek një rrugicë e një lagje, në atë rrugë ka mundur të vendoset një semafor sa për sy e faqe si thonë populli, me një dritë pandërprerë me qasje me kujdes, pra nuk është problemi i vendosjes së një semafori, problemi qëndron se kur duhet të lejohet qasja në atë rrugë.

**Kryetar**- Së pari pyetja është me vend, por ne asnjëri që jemi këtu nuk jemi ekspert e komunikacionit, për menaxhimin e këtyre semaforëve kanë ardhur ekspert nga Maqedonia sepse në Kosovë nuk kishte ekspert të komunikacionit. A duhet të ndryshohet minutat për qasje në atë rrugë, për besë nuk e di, ne e kemi paguar kompaninë ata sipas ekspertëve kanë vendosur që ashtu duhet të jetë, më shumë unë nuk e di dhe nuk mundem të japë përgjigje sepse nuk jam më kompetent, por kjo është përgjigja nga ana e tyre si ekspertë.

**Përparim Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket semaforëve, jam marrë me kompaninë e cila i ka vendos semaforët, ata një javë kanë bërë diagramin e lëvizjes së veturave në dy udhëkryqet e Rahovecit, në bazë të këtij diagrami vendoset orientimi i trafikut me minutazhin që caktohet në semafor. Kurse sa i përket rrugës Ali Hasku, ne kemi dalë edhe me njoftim publik, sepse për vendosjen e semaforit duhet të jetë rruga dy kaheshe, kurse kjo rrugë ka vetëm një drejtim. Për momentin ekspertët e komunikacionit kanë vendosur që të gjitha semaforët të bllokohen 4 sekonda në mënyrë që ti lejohet qaja e makinave në këtë rrugë, kjo është e gjitha.

**Kryetari** – Sa i përket asaj që e tha komandanti për projektin e bombolave të gazit, unë jam pro asaj që të jenë të gjitha restorantet dhe pompat e derivateve të pajisura, poashtu të jenë në gjendje të rregullt ato bombola. Inspektorati duhet të bëjë kontrolle që të sheh se a janë të pajisur të gjitha ata që e kanë për obligim. Sa i takon takimit me banorët e Hoçës së Madhe, unë sapo e mora vesh, por nëse fillohet edhe me bagëti të merremi për çështje etnike besoj se nuk do të ishte mirë. Gjithmonë ka qenë ky problem nëse mundemi të shprehemi kështu, gjithmonë kanë pasur këso probleme Rahoveci, Brestoci, pastaj Hoça Madhe dhe fshatrat e tjera, gjithmonë e kishin këtë shqetësim se jo ky po na lëshon begatit në fusha etj etj. kjo nuk bëhet për ndonjë motiv patriotik ose etnik, por i lëshojnë begatit, por mendoj se ky problem ky zgjidhje, prandaj i lusim blegtorët tanë që mos ti shqetësojnë banorët e Hoçës së Madhe dhe banorët e tjerë, pra mos ti bëjnë dëme nëpër kullosa ose vreshta. Kam një propozim kush donë le të më bashkohet mua të shkojmë të i vizitojmë banorët e Hoçës së Madhe, kurdo që ju vendosni, kam qenë për debate publik dhe shumë mirë kemi kaluar me banorët e Hoçës së Madhe, shumë mirë jemi mirëpritur.

Ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë në pikën e tretë të rendit të ditës, kalojmë në pikën e radhës.


#### 4. Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike.

Kjo pikë e rendit të ditës mundemi të themi se i përket më shumë bisedës që ne e patëm deri ë tani. Lirishtë mundemi të themi se marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Rahovecit nuk janë problematike, ne i kemi disa probleme sa i përket një rruge tek varrezat ortodokse, por ne kemi bërë një kërkesë tek kisha ortodokse në Prizren por asnjë herë nuk na përgjigjen ata, jo vetëm për këtë por për asgjë nuk na përgjigjen, banorët kërkojnë kurse ata nuk na përgjigjen. të gjitha shqetësimet që i kanë ne i diskutojmë me zyrën komunale për komunitete që është në komunë, poashtu ne kemi kontakte edhe me përfaqësuesit që ata i kanë në qeverinë qendrore dhe përmes edhe atyre ne i kryejmë disa projekte përmes disa fondeve që i kanë ata të ndara për pakicat. Po e potencoj edhe një herë se situata ndëretnike në komunën tonë deri më tani është shumë në nivel, nuk ka ndonjë akçes i cili duhet të diskutohet. Kalojmë në pikën e fundit për këtë mbledhje:

#### 5. Të ndryshme.

A ka dikush të shtojë diçka sa i përket kësaj pike, nëse jo atëherë ju falënderoj për kontributin e dhënë, shihemi në takimet e radhës.

**Mbledhja ka përfunduar në orën: 16:40**

  
Procesmbajtësi  
Agim Hoti

  
Kryetar i Komunës  
Smajl Latifi